



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Endrit Ismailaj** me datë **22.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Verifikimin e kushteve dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për personin nën hetim **Endrit Ismailaj**, të caktuar nëpërmjet vendimit nr. 37, datë 10.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, i lënë në fuqi nga kjo gjykatë me vendimin me nr.39, datë 14.04.2024”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 228 e vijues, 246/6 dhe 260 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **598**, datë **14.11.2024**, vendosi:

1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr.188 të vitit 2023, dhe nevojat e sigurimit të kërkuesit **Endrit Ismailaj**, dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar ndaj tij me vendimin nr.37, datë 10.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 14.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar